

Blerim CARANI

**NDIKIMI I ORGANEVE SHETËRORE - “POPULLORE” NË
ZBATIMIN E REKUIZIMIT NË KOSOVË NËN MBIKËQYRJEN E
PROKURORISË PUBLIKE GJATË VITEVE 1945-1952**

Abstrakt:

Rekuizimi,¹ ishte fushatë plaçkitëse, ekonomike me pasoja psikike dhe shumë komplekse, të cilën e bënte vetë përzierja e shtetit në zbatimin dhe argumentimin e saj. Për të zbatuar këtë politikë rekuizuese, u përdorën edhe organet duke filluar nga këshillat vendorë e të rretheve, të cilat në mënyrë hirearkike raportonin deri te Ministria e Tregtisë dhe Furnizimit të RPFJ-së. Po ashtu u morën masa për sensibilizimin e këtyre organeve dhe të masës fshatare në përgjithësi, mbi të cilët u ra dhe barra kryesore e fushatës. Shfrytëzuan edhe shtypin, me thirrjet e njohura të asaj periudhe që “asnjë pëllëmbë toke të mos mbetet e papunuar”. Pastaj i inventarizuan tokat e çdo familjeje, i numëruan sasi të ushqimit dhe të farës për mbjellje për vitin tjetër, që duhej hedhur. Për secilin vend madje edhe rreth ndryshonin statistikat e rekuizimit, po ashtu dhe mënyrat e mbledhjes etj.

Fjalë kyçe: *Rekuizim, prokurori, organe të pushtetit, masa, propagandë etj.*

¹ Rekuizim d.m.th të marrësh me detyrim, me shpërblim ose përkohësisht prodhime, mjete a sende të tjera për nevoja të përgjithshme ose ushtarake në disa raste të veçanta. Rekuizimi mund të jetë - rekuizim i mjeteve të transportit, i drithërave, i pasurisë, me pagesë etj. Krahaso: Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe N-ZH, (Prishtinë, Rilindja, 1981), 1645. Në gjuhën angleze Requisition (rekëi-zishën) - zaptim, përvetësim Krahaso: Stuart E. Man. Fjalor Anglisht - Shqip, (Londër, 1957), 315.

Ndikimi i organeve për zbatimin e rekuizimit

E tërë politika rekuizuese ishte e rregulluar dhe e zbatuar me anë të rregulloreve udhëzimeve, akteve, dekretligjeve, urdhëresave të hartuara nga RPFJ-së dhe Serbia-Ministria e Tregtisë dhe Furnizimit (MTF), të cilat ishin të vlefshme për shumicën e vendeve të ish-Jugosllavisë dhe Kosovës në veçanti. Zbatimi dhe respektimi i tyre bëhej nga organet e formuara dhe të quajtura “organe të pushtetit popullor”. Duke filluar nga këshillat vendorë e të rretheve, të cilat i raportonin gjithnjë deri te Ministria e Tregtisë e Furnizimit, nën mbikëqyrjen e prokurorive publike.

Politika e udhëhequr në këtë drejtim, ngaqë kishte filluar formalizimin e saj që me dispozitat e para nga viti 1945, përmes dekreteve federale dhe atyre republikane, krahas qëllimit që kishte për furnizimin e “ushtisë dhe popullsisë së uritur,” në të njëjtën kohë shtrihej si presion mbi popullsinë fshatare, që konsiderohej si e pasur, përkatësisht kullake. Kjo politikë, e udhëhequr nga ana e PKJ-së dhe e Frontit Popullor, do të shtrihej me gjithë peshën e saj në të gjitha njësitë e federatës së atëhershme, e veçanërisht në Kosovë për disa vite rresht.²

Grumbullimi i detyrueshëm në fillim ishte në drithëra e më vonë u zgjerua edhe në produktet tjera bujqësore. Në ligjin për planin e parë 5-vjeçar federativ (1947-1951), Kosova nuk u veçua për zhvillim të shpejtuar, ashtu siç u veprua me republikat e Bosnjë-Hercegovinës, të Maqedonisë e të Malit të Zi. Për këtë arsye, ndërsa republikave të tjera të pazhvilluara iu ndan investime pa detyrim kthimi, d.m.th. falas, Kosova nuk u përfshi në këto masa favorizuese.³ Duke bërë krahasime mes drithërave të cilat prodhoheshin në Kosovë dhe atyre në Serbi e Vojvodinë si p.sh. prodhimi i misrit në Serbi është më i madh për 27% se në Kosovë dhe ai në Vojvodinë afër 50%, se kualiteti i tokës në Kosovë nuk ishte më i dobët nga ai i Serbisë dhe se nuk mbetej shumë larg atij të Vojvodinës.⁴ Secili rreth në Kosovë i kishte këshillat e veta, ku hynin fshatarët më të mirë e më të vyeshëm (sipas pushtetit të

² Musa Limani, *Politika ekonomike*, Prishtinë, 1994, 419.

³ Ana Lalaj, *Kosova rruga e gjatë drejt vetëvendosjes 1948-1981*, Mësonjëtorja e parë, Tiranë, 2000, 69.

⁴ Gazeta “Rilindja” Viti III Nr. 90, Prishtinë, 5 tetuer 1947, Asambleja VII e zakonshme e Asamblesë së KP Krahinor për KM, emrin e shkruarit të artikullit nuk e posedojmë.

atëherëshëm të RPFJ-së). Për ta kryer rekuizimin e drithërave drejt sipas dekretit të ri në vitin ekonomik 1946/47, ishin marrë masat e nevojshme ngaqë u ishin dhënë udhëzime këshillave popullorë për sa i përket mënyrës së re të rekuizimit të drithërave (me lëndën më themelore të ushqimit). Sipas këtyre masave së pari duhej të bëhej regjistrimi i sipërfaqeve të mbjella, të përpilohej plani i punës së makinave shirëse, të organizonin konferenca e kampanje, të formoheshin ndërmarrje për depozitimin e drithërave, si dhe të bënin gara në mes veti se kush po blen më shumë drithëra etj.⁵ Për përcaktimin e saktë të sasive të ushqimit me drithëra, miell e patate në dispozicion të popullsisë, u formuan komisione të posaçme për të kryer inventarizimin dhe kontrollin në çdo vend, fshat apo qytet. Këto Këshilla ishin të detyruara të hartonin listat e duhura me të dhëna të sakta për pronarët e shtëpisë: emrin dhe mbiemrin, vendbanimin, numrin e anëtarëve të familjes, sasinë e ushqimeve të disponueshme veçmas për çdo produkt, mungesën ose tepricën e ndonjë ushqimi.⁶

Grumbullimit të prodhimeve bujqësore doemos duhej kushtuar një kujdes jashtëzakonisht i madh. Këshilli Popullor i rrethit merrte planin e grumbullimit, të cilin më pas e shkoqiste te këshillat popullorë lokalë. Në këtë punë angazhoheshin edhe të gjitha organizatat shoqërore-politike dhe qytetarët, të cilët në tubimet e zgjedhësve, merrnin pjesë në përcaktimin e sasive. Qëndrimi ishte që barra kryesore e grumbullimit të binte mbi familjet ekonomikisht më të forta, por aplikoheshin edhe masa të nxitjes së grumbullimit mbi sasinë e planifikuar, ndërmjet të ashtuquajturës tregti e lidhur.⁷ Për hir të performancës së suksesshme në masë, organizatat do të zhvillojnë propagandë të gjerë, për të ndihmuar në ekzekutimin praktik të përgatitjeve organizative, mbajtjen e shënimeve në zhvillimin e garave ndërmjet vendit.⁸

⁵ *Këshilli Popullor i Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë (1943-1955)*, 85-86.

⁶ Виолета, АЧКОСКА, *Задолжителниот откуп во Македонија 1945 - 1953* - Скопје, Институт за национална историја, 1995, 160.

⁷ Grup autoresh, *"Mitrovica e Titos" 1945-1980*, Pushteti popullor 1945-1955, "Rilindja", Prishtinë, 1985, 26.

⁸ Gazeta "Borba", Fleta Zyrtare e RSFJ-së, 1946, Titulli: Përgatitjet për mbjelljen vjeshtore në Kosmet, E martë, 8 tetor 1946, Prizren.

Kjo bëhej që të përpiloheshin shënimet definitive në bazë të regjistrimit të llogaritjeve, duke filluar nga regjistrimi i llogaritjeve në këshillat vendorë (regjistrimi nëpër familje) dhe duke kaluar në regjistra të përgjithshme të këshillave të rretheve, në mënyrë që të bëhej rikapitullimi për tërë krahinën-territorin. Sipas këtij regjistrimi, duhej të merreshin shënimet definitive për sasinë e kryer të rekuizimit të tepricave obligative nga prodhimtaria, dhe për sasinë e rekuizimit të tepricave obligative nga ujemi i makinave-shirëse. Kjo do të thotë që në bazë të këtyre shënimeve duhej të formohej një pasqyrë e qartë për rekuizimin e tepricave obligative për secilin këshill (se sa i takonte secilit këshill t'i rekuizonte këto teprica).

Pastaj, duhej të dihej se kush ishte ngarkuar me barrën e tjetërkujt (barrën që nuk i takonte) ngaqë atij që i takonte duhej të rekuizonte: a) teprica detyrimore nga prodhimi, b) teprica detyrimore nga makinat e veta shirëse.⁹ Më pas duhej të dihej se sa ishte e saktë në përqindje lista e familjeve bujqësore, si ishin kryer përgatitjet për shirje; si shkonin shirjet dhe deri ku kishin arritur: A ishin formuar në çdo vend komisionet për rekuizimin e drithërave? A udhëhiqeshin librat me rregull (librat e matjes, të llogaritjes dhe raporteve javore të dorëzuara)? A ishin formuar stacionet grumbulluese dhe si po punonin? Sa ishin çmimet e grurit në shitje të lirë? A kishte shenja (dukuri) të rritjes së çmimeve nga ana e tregtarëve të sektorit privat? A po i lidhin kooperativat dhe ndërmarrjet shtetërore tregtare marrëveshjet me prodhues për blerjen e tepricave të lira dhe a po i ngritin edhe ata çmimet? A kishte shenja të luajtjes me dispozita të rekuizimit të tepricave obligative me anë të fshehjes, shkatërrimit, si po punonin prokurorët publikë dhe sa kishin kontribuar në zbatimin e drejtë të urdhëresës për grumbullimin e drithërave për vitin ekonomik 1946/47? A kishte pasur veprime sipas ligjit mbi luftimin e spekulimeve të palejuara dhe sabotimit ekonomik.

Për t'u vërtetuar të gjitha këto, formoheshin komisione pranë seksioneve të tregtisë ndër këshillat popullorë të rrethit dhe komisione që duhej të punonin për një kohë të caktuar pranë këshillave popullorë të vendit. Këto komisione duhej të mblidhnin të gjitha shënimet e nevojshme për regjistrimin, blerjen dhe shpërndarjen e drithit. Ky ishte plani, mënyra me të

⁹ASHK, PP e KAKM, K. 4, dok. nr. 2160, "Zhitopromet" Prishtinë 6 nëntor 1946, dërguar prokurorit publik të Kosovës, Këshillit Krahinor dhe Sektorit për Tregti dhe Furnizim - Prishtinë, (Lënda: Përshpejtimi i rekuizimit të drithërave).

cilën pushteti do të fillonte punën për të plotësuar këto detyra. Këtu, duhej të merrnin pjesë edhe Fronti Popullor, të gjitha organizatat tjera, këshillat e rinisë shqiptare, Fronti Antifashist i Grave, sindikatat, kooperativat dhe çdo qytetar i ndershëm për t'i plotësuar këto detyra sa më shpejt dhe sa më mirë së bashku.¹⁰

Stacionet për blerjen e drithërave bënë blerjen në të gjitha rrethet ku drithi ishte në suficit. Rezultatet deri diku ishin të mira, por jo edhe ashtu siç duhej të ishin. Organizatat e popullit, komisionet për blerje dhe organet e pushtetit popullor duhej të tregonin më tepër aktivitet dhe mjeshtri, prandaj organizoheshin gara për blerjen e drithit në mes të këshillave popullorë. Këto gara bëheshin me qëllim që të përfundohej sa më shpejt blerja, sepse kështu kishin sukses më shumë.¹¹

Gjithashtu, duhej t'u përfundohej pagesa profesioneve private si: tregtarëve, zanatxhijve, kafexhive, mjekëve, avokatëve dhe pronarëve të shtëpive. Kjo pagesë bazohej sipas shkallës së parë për vitin 1946, por aty suksesi ka qenë edhe më i keq, sepse Këshilli Popullor i qytetit, në pagesën e tij, ishte angazhuar edhe më pak se këshillat popullorë të rrethit në pagimin e tatimit nga bujqit. Rezultatet më të mira ishin në K. A. e Vojvodinës, ku ishin kushtet më të mira për pagesa.¹² Korret-shirjet në Kosovë, të cilat ishin afër nuk ishin problem vetëm për fshatrat dhe fshatarët të cilët lëvronin dhe as të këshillave për korre-shirje, por ishin problem i gjithëmbarshtëm popullor, i gjithë rrethit tonë, pushtetit popullor dhe të gjitha organizatave të Frontit Popullor.¹³

Me analizën e rekuizimit ishte konstatuar se në terren ndodhnin gabime, prandaj u urdhërohej shtabeve që të kishin kujdes të veçantë. Realizimi i kësaj detyre duhej të bëhej me seriozitet të plotë dhe rregullsi duke pasur kujdes që obligimet e pakryera, madje edhe sasitë më të vogla të ndikonin në lartësinë e fondit të drithërave, në rezervat e shtetit, pra në fuqinë e tij përgjithësisht. Prandaj, asnjë nga detyrat e parashtruara nuk guxonte të

¹⁰ *Rilindja*, 1945-46 -sqarim për arsye të kopjimit të dobët mungon numri i faqes.

¹¹ *Rilindja*, 30 gusht 1946, nr. 51.

¹² ASHK, Fondi-Prokuroria Publike e KAKM 1947, kutia-4, Dok sekret nr. 455/47, Prokuroria publike e RP e Serbisë-Beograd, dërguar të gjithë prokurorëve publikë, (Lënda: Pagimi i tatimit).

¹³ *Gazeta-Jedinstvo*, Prishtinë, 1945-1946, nr. 16, 7.

zgjidhej pjesërisht. Për kryerjen e detyrave të parashtruara duhej vendosur kontroll ditor dhe hetim të vazhdueshëm, andaj iu udhëzohej komisionet vendore dhe të rrethit të informoheshin menjëherë për arritjen e kësaj qarkoreje, të cilën do ta shqyrtonin në mbledhje lidhur me situatën në rreth duke aprovuar vendimet e duhura.¹⁴

Me vendimin e komisarit shtetëror për furnizimin u emërua shtabi për grumbullimin e drithërave të bardha të Këshillit Popullor të qarkut, në të cilën ishin të përfshirë:

1. Komisari shtetëror për furnizim, shoku Milosh Javanoviq;
2. Ndihmëskomisari shtetëror për furnizim, shoku Veljko Vukotiq;
3. Drejtori i Zhitoprometit, shoku Sima Vasiljeviq;
4. Zëvendësdrejtori i bazës së grurit, shoku Supki Bajrami;
5. Drejtori i Drejtorisë për grurë, shoku Ilija Tomiq;
6. Drejtori për grumbullimin e kafshëve, shoku Milan Rakoviq;
7. Shefi i Byrosë së Evidencave Operative, shoku Jevto Peroviq;
8. Refreni për grumbullim të grurit, shoku Miodrag Peroviq;
9. Drejtori i sektorit planifikues, shoku Krsto Nikiq.

Në fund të mbledhjes u bë ndarja e terrenit për anëtarët e Shtabit dhe këta:

1. Simo Vasiljeviq - Suharekë, Prizren dhe Dragash;
2. Subki Bajrami - Rahovec dhe Gjakovë;
3. Milan Rakoviq - Kamenicë dhe Gjiilan;
4. Ilija Tomiq - Skënderaj dhe Mitrovicë e Kosovës;
5. Veljko Vukotiq - Pejë dhe Gjurakovc;
6. Krsto Nikiq - Vushtrri dhe Prishtinë;
7. Jevto Peroviq - Lipjan dhe Ferizaj;
8. Millosh Jovanoviq - Podujevë;
9. Miodrag Peroviq, obligohet që të jetë përgjegjës për evidencat e grumbullimit, të mbajë lidhje telefonike me këshillat popullorë të rretheve dhe shtabin republikan në Beograd. Lidhja në mes të shtabeve do të mbahet

¹⁴ ASHK, PP e KAKM, K. 2, RPS, MSHF, Drejtoria për rekuizimin e drithërave dhe ushqimit të kafshëve, bes. Nr. 9918, Urgjentë, Beograd, 31.08.1949, Nënshkruar nga ministri, Toma Granfil. Originalitetin e konfirmon drejtori i Drejtorisë për Drithëra dhe Ushqim të Kafshëve, Midrag Kostiq.

për çdo ditë me telefonin nr. 125 në Prishtinë. Këshillimet do të mbahen çdo të dytën ditë.¹⁵

Në bazë të nenit 12, më saktë 18 të Ligjit për Planin Zhvillimor Pesëvjeçar, Ministria e Bujqësisë e Republikës Popullore të Serbisë, përcakton: *Udhëzime të detyruara* për ndihmën profesionale të agronomëve të rretheve për kooperativat e punës fshatare. Për zbatimin e të gjitha udhëzimeve do të kujdesen këshillat popullore të Kosovës, këshillat kryesorë të Kuvendit Popullor të Vojvodinës dhe organet kompetente të Ministrisë së Bujqësisë së Republikës Popullore të Serbisë.¹⁶

Mirëpo për këtë duhej edhe propagandimi (kampanja) i shtypit nëpër konferenca e tubime në mënyrë që të ngrihej disponimi i masave për kryerjen e detyrimeve rekuizuese. Me planin e mbjelljeve parashihej që me drithëra të bardha të mbillej 92% e tokës së gjithëmbarshme. Shteti ynë kërkonte nga fshatarësia punëtore ngaqë atë vit duhej të jepej bukë më shumë se vitin e kaluar, si dhe në punët tjera duhej të angazhoheshin në përmbushjen e planit pesëvjeçar. Fshatarësia jonë e vyeshme atë vit do t'i jepte më shumë drithë shtetit, duke e ditur se e vazhdonte rrugën në të cilën kishte shkuar në luftën NÇ, duke qëndruar krah për krah me klasën punëtore, duke dërguar në front fëmijët e vet për t'i furnizuar radhët tona partizane dhe ushtrinë NÇ. Atë vit baza ekonomike e lidhjes së fshatarësisë me punëtorë ishte më e fortë se sa më parë.¹⁷

Sa u përket korrje-shirje nuk iu përket vetëm fshatarëve, të cilët lëvrojnë, as këshillave për korrje-shirje, por ishte problem i gjithëmbarshtëm popullor, problem i gjithë rrethit, pushtetit popullor dhe të gjitha organizatave të Frontit Popullor. Qeveria popullore e Serbisë në zbatimin e kësaj fushate kishte ofruar ndihmë 120 traktorë dhe 550 vagonë drithë për farëra. Mirëpo, kjo ndihmë kishte edhe prapavijën e vet, sepse pushtetet popullore dhe organizatat e Frontit Popullor duhej t'i ofronin ndihmë kolonistëve, të cilët

¹⁵ASHK, Prokuroria Publike e KAKM, K-2, 8.IX.1949, Prishtinë, Procesverbal i mbledhjes së mbajtur të Shtabit për grumbullimit e drithërave të bardha të këshillave popullorë të qarqeve më 8 të këtij muaji ku kanë marrë pjesë, dërguar prokurorive publike të këshillave popullorë të rretheve.

¹⁶ Arkivi Ndërkomunal i Mitrovicës (ANKM), Ndhimëskomisioneri i Bujqësisë dhe Pyltariisë, Ing. Dragutin Jaksiq, K-21.

¹⁷ Jedinstvo, 1946-1947 (aprovimi i planit të mbjelljeve).

ishin pa bagëti dhe mjete për bujqësi. Në fushatën për mbjellje posaçërisht duhej t'iu kushtohet kujdes për mbjelljen e arave të invalidëve të luftës, nënave dhe jetimëve të luftës për forcimin, siç thuhej “të vëllazërim-bashkimit në mes të popujve tanë. Kështu, serbi le t'i ndihmojë shqiptarët dhe anasjelltas shqiptarët-serbit dhe malazezit, prandaj me traktorët të cilët do të merreshin, duhej të mbilleshin tokat e shqiptarët, serbit e malazezit”. Në fund jepej një “këshillë” për çdo banor të Kosovës dhe interesit jetësor që ka, Kosova të mos mbetet pa bukë të mjaftueshme për të gjithë banorët e saj. Sot është koha dhe rasti që kjo të zbatohet në vepër. Në këshillat për mbjellje të hyjnë fshatarët më të mirë dhe më të vyeshtëm”.¹⁸

Fshatarët, për të cilët këto akte më së shumti ishin sjellë, nuk ishin të informuar fare dhe as që i kishin lexuar (sepse 70% e popullsisë fshatare ishin analfabetë), por kishin detyrim për përmbushjen e këtyre akteve.¹⁹ Rekuizimi i drithit paraqiste “pasqyrën e punës së organizatave masovike.” Këshillat popullorë vendorë kritikoheshin për mosorganizimin e garave për përmbushjen e planit të rekuizimit.²⁰ U kërkua që të vazhdohej lufta përmes organeve të pushtetit që rekuizimi mos t'i lejohej stihisë dhe se direktivat duhej të zbatoheshin me çdo kusht me kontrolle ditore: “Atë çka e kemi paraparë për ne është ligj”, - kosideronte Kidriqi.²¹

Që të rritej fondi i shtetit sa më shumë, përpos dërgesave obligative të drithërave, me anë të disa dekretligjeve, iu kanë imponuar fshatarëve që edhe atë teprice të mbetur të drithit, t'ia shesin ndërmarrjeve shtetërore me çmim të caktuar. Për këtë qëllim kanë organizuar edhe kampanjë të rekuizimit për të gjitha rrethet e Kosovës, deri më dt. 04.VIII.1947 në orën 14:00. Për këtë kampanjë kanë raportuar me telefon për çdo ditë.

Po e paraqesim mënyrën (pasqyrën) se si ka shkuar kampanja në rrethin e Llapit për ca ditë:

¹⁸ Gazeta “Jedinstvo” Prishtinë, Nr-16, 1945-1946, 7.

¹⁹ Momçillo Pavllloviq, *Srpsko Sello 1945-1952-Otkup*, Institut za savremeno istoriju, Beograd 1997, 17.

²⁰ Momçillo Pavllloviq, *Srpsko Sello...*, 9.

²¹ Po aty, 30.

Dërgesat e detyrueshme				Teprica			
Rrethet tona				sasia e rekuizuar			
				sasia e përcaktuar			
Grurë elb tërshërë				grurë elb tërshërë			
Llapi	381	82	46	31	14	1	75 18 18

Kampanja e rekuizimit përmbyllës për datën 05.VIII.1947 deri në orën 14:00

Llapi 408 88 50 42 15 1 80 19 19

Kampanja e rekuizimit përmbyllës për datën 06.VIII.1947 deri në orën 14:00

Llapi 435 94 54 50 16 1 85 20 20

Kështu me radhë deri te përfundimi i kampanjës më 23.IX.1947.²²

Gjatë kësaj faze në Kosovë, si dhe në disa pjesë të ish-Jugosllavisë, do të sforcohet procesi i mbledhjes së tepricave deri në "fshirjen e magjes" nga ana e organeve shtetërore dhe sidomos nga ana e aktivistëve politikë të Frontit Popullor për realizimin e detyrave që kishin marrë. Lidhur me këtë qëllim pushteti federal, po edhe ai i Serbisë posaçërisht do të nxjerrin një vaster aktesh juridike, në veçanti dekretligje dhe urdhëresa për të zbatuar këto synime, madje duke i ndryshuar dhe përshtatur sipas zbatimit të rrethanave në teren.²³

Shteti ynë përfshinte në plan edhe prodhimet bujqësore, sikurse të gjitha prodhimet tjera. Furnizimi i popullit me bukë do të sigurohej duke u krijuar fondi shtetëror i përbashkët i drithit. Ky fond u formua në rendin e parë me blerjen e detyrueshme të drithërave nga bujqit. Pikërisht për këtë qëllim, qeveria e përbashkët qysh më 15 mars të vitit (1947) kishte dhënë dekretligjin për blerjen e drithërave. Sipas këtij dekretligji, çdo bujk ishte i detyruar që një pjesë të drithërave të prodhuara t'ia shiste shtetit me çmim të caktuar.

²² ASHK, PP e KAKM, K.2, PPRR, Prishtinë, Raport përmes telefonit për çdo ditë mbi kampanjën e zhvilluar të rekuizimit të drithërave të bardha sipas llojeve dhe mënyra e rekuizimit në tërë qarkun autonom të Kosovës.

²³ Fatmir Sejdiu, *Politika agrare si instrument i shtypjes nacionale në Kosovë*, Prishtinë: 2001, 138-139.

Për këtë arsye çdo bujk përafërsisht duhej ta dinte se sa ishte i detyruar t'i dorëzonte shtetit e sipas kësaj të mbillte edhe tokën që të mund t'i kryente detyrimet. Nga ana tjetër këshillat popullorë, me kohë para korries dhe fshirjes, do t'i tregonin çdo bujku sasinë që duhej ta dorëzonte në magazinën e shtetit.

Mënyra se si është bërë kategorizimi

Kategoria I prej 1 deri 3ha, detyrohej t'i jepte për 1ha, më së

Shumti.....	215 kg
Kat. II.....3.....5 ha.....	310 kg
Kat. III.....5.....8.....	510 kg
Kat. IV.....8.....10.....	690 kg.
Kat. V.....10.....15.....	530 kg.
Kat. VI.....15.....20.....	1 150 kg.
Kat. VII.....20 e më tepër.....	1 300 kg. ²⁴

Në bazë të ligjit qeveria e RFPJ-së, me propozim të ministrit të Tregtisë dhe Furnizimit dr. Zaima Sharca, më 26 prill 1946 nxori (miratoi) urdhëresën për rekuizim të drithërave për vitin ekonomik 1946/1947. Këtë urdhëresë e nënshkroi ministri-kryetari i Qeverisë së RFPJ-së dhe ministri i Mbrojtjes Popullore, mareshali J. B. Tito.²⁵ Kjo ishte njëra ndër rregulloret e para, e cila ishte e shpallur edhe në gazetën zyrtare të RP të Serbisë në Beograd më 22 qershor të vitit 1946, nr. 51348. Në bazë të kësaj rregulloreje, gjoja kishte filluar në “mënyrë juridike” shteti i RFPJ-së, ta zbatonte politikën e rekuizimit-gjegjesisht të fillonte të bënte përcaktimin e sasive të drithërave për vitin ekonomik 1946/1947, nëpër njësitë federale të saj. Kjo rregullore ishte publikuar nga Ministria e Tregtisë dhe Furnizimit dhe përmbante 15 nene. Në vijim po e paraqesim Neni-5, i cili jep këtë sqarim:

Për disa kategori të prodhuesve duke pasur parasysh (duke u bazuar) në madhësinë e pronës së tyre të përgjithshme, caktohej minimumi apo maksimumi i dërgesave obligative gjegjesisht tepricave të lira sipas tabelës në vijim:

²⁴ Gazeta *Rilindja*, Prishtinë, 1945, nr. 77, 5.

²⁵ ASHK, Fondi-Prokuroria Publike e KAKM 1946, Kutia-4, Prokuroria Publike e RP e Serbisë, Nr. 2403/46, 14 maj 1946, Beograd, (Lënda: Njohja me dispozitat (rregullat) e Rregullores mbi rekuizimin e drithërave në vitin ekonomik 1946/47.

Kateg.	Madhësia e Pronës	Dërgesat obligative		Tepricat e lira		Vërejtje
		Min.	Max.	Min.	Max.	
I	Pronën e përgjithshme deri në 3ha prej të cilës e punueshme deri në 2ha	40%	80%	60%	20%	Nëse nuk ishin kushtet nga neni 6 i rregullores në atë rast tepricat e lira mund të ishin edhe më të mëdha apo prodhuesi mund të lirohej plotësisht nga dorëzimi i drithit.
II	Prona e përgjithshme deri në 3ha prej të cilës e punueshme përtej 3ha	60%	80%	40%	20%	Nëse nuk qëndronin kushtet sipas nenit 6 të rregullores në atë rast tepricat llogariteshin sikurse për prodhuesit e kategorisë së mëparshme.
III	Prona e përgjithshme prej 3-5ha	60%	80%	40%	20%	Nëse nuk qëndronin kushtet sipas nenit 6 të rregullores në atë rast tepricat

						llogariteshin sikurse për prodhuesit e kategorisë së mëparshme.
IV	Prona e përgjithshme prej 5-8ha	65%	80%	35%	20%	
V	Prona e përgjithshme prej 8-10ha	70%	30%	30%	20%	
VI	Prona e përgjithshme prej 10-15 10-prej 10-15ha	80%	90%	20%	10%	
VII	Prona e përgjithshme prej 15-20ha	85%	90%	15%	10%	
VIII	Prona e përgjithshme përtej 20ha	90%	90%	10%	10%	Dërgesat obligative në çdo rast nëse nuk qëndronin kushtet sipas nenit 6 të rregullores, në këtë rast llogariteshin sikurse për kateg. VII ²⁶ .

²⁶ ASHK, PP e KAKM, K. 4, (Rregullore e shpallur në gazetën zyrtare të RP të Serbisë, në Beograd, më 22 qershor të vitit 1946, nr. 51348).

*Sqarim: Kjo është njëra ndër rregulloret e para në bazë të së cilës gjoja ka filluar ne “mënyrë juridike”, shteti i RPFJ-së, ta zbatojë politikën e rekuizimit-gjegjësisht të fillojë të bëjë përcaktimin e grumbullimit të drithërave për vitin ekonomik 1946/1947, nëpër njësitë federale të saj, e sidomos atyre që e kishin tokën më pjellore, se sa duhet dorëzuar shtetit, pra kjo rregullore është nxjerr nga Ministria e Tregtisë dhe Furnizimit dhe ju ka dërguar të gjitha prokurorive publike të njërive dhe krahinave e po ashtu edhe asaj të Kosovës, të cilat u deshtë ta zbatojnë. Por kjo nuk ishte e përgjithshme dhe unike, por këto rregullore edhe i kanë ndryshuar apo plotësuar, varësisht nga rrethanat e zbatimit të saj në terren.

Për këtë qëllim ishin bërë publike këto dekretligje nëpër shtypin e kohës, në mënyrë që të ishin më bindëse, si dhe të mos keqpërdreshin nga ana e këshillave vendorë, për shkak se edhe çmimet e drithërave që i blinte shteti, i kishte caktuar qeveria e RPFJ-së. Në vijim po e citojmë një nen të këtij dekretligji, i cili përmban gjithsej 7 nene: në nenin e parë thuhej:

Neni 1

“Që të sigurohej dhe ndahej në mënyrë të drejtë fondi i drithit, në vitin ekonomik 1949-1950 duhej të bëhej blerja e detyrueshme e drithërave. Sipas dispozitave për blerjen e detyrueshme të drithërave, bujqit dhe kooperativat katundare të punës detyroheshin që t’ia shisnin shtetit sasinë e caktuar të drithërave: grurit, elbit, tërshërës, misrit etj”.²⁷

Me qëllim të respektimit të dekretit për mbjelljen e detyrueshme të tokës së punueshme dhe në bazë të Urdhrit të Qeverisë së RFPJ-së, Qeveria e Republikës Popullore të Serbisë lëshon: *urdhëresë* për kryerjen e kësaj mbjellje do të kujdeset Këshilluesi Ekzekutiv i Asamblesë Popullore të Krahinës Autonome të Vojvodinës, Këshill Ekzekutiv i Qarkut të Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë dhe këshillat popullorë ekzekutivë të qarkut dhe këshillat popullorë të rretheve në Republikën Popullore të Serbisë.²⁸

Për ndryshim nga vitet e mëparshme rregullorja e re për rekuizim, i obligonte edhe këshillat popullorë vendorë që me kohë d.m.th. para fillimit të mbjelljeve t’i tregonin prodhuesve se sa duhej të ishte obligimi i tyre për vitin vijues. Me këtë i mundësohej prodhuesit që të planifikonte prodhimin në mënyrë që t’i kryente obligimet ndaj shtetit dhe të plotësonte nevojat e veta. Krahas kësaj, kjo rregullore e re parashihte ngarkimin për çdo familje që i kishte mundësitë për të dorëzuar edhe sasi të minimale të disa prodhimeve ngaqë nuk ekzistonte kategoria “C”. Pra, me këtë, dorëzim-dërgimin do të

²⁷ Rilindja, 1949-1950, Në bazë të nenit 1. Ligjit mbi autorizimin e Qeverisë së RFPJ-së për prurjen e dekreteve në lidhje me çështjen e ekonomisë popullore, Qeveria e RFPJ-së, në bazë të propozimit të Ministrisë së Tregtisë dhe të Furnizimit të RFPJ-së.

²⁸ ANKM, Qeveria e Republikës Popullore të Serbisë. K-1, B. C. 174, 25 Mars 1947, Beograd. (Kryetari i Qeverisë së RPS. Rade Nedelković d. v., Ministri i Bujqësisë së RPS, dr. Bllagoje Nesković, d. v, Shef i sektorit administrative, (Radosav Vijatović), lëshuan Urdhëresën dhe ju shpërndan Këshillit Ekzekutiv të Serbisë, Vojvodinës dhe Kosovës.

kryenin një numër më i madh i prodhuesve dhe kështu do të mundësohej ngarkim-detyrimi i barabartë për çdo prodhues.²⁹

Personeli i stacioneve grumbulluese të “Zhitoprometit” duhej ta njihte mirë urdhëresën e atëhershme për rekuizimin e drithit, si dhe duhej të merrej me të gjitha punët teknike rreth zbatimit në jetë. Pastaj, duhej që mirë të dinte punët rreth ndarjes së bonave (triskave), të caktonte kualitetin e drithit, rregullisht t’u dorëzonte raportet këshillave popullorë vendorë e të tjera. KPV-ja kishin obligim që të përcillnin nga fillimi evidencën e përditshme për dorëzimin e drithit (që kishin obligim qytetarët ndaj shtetit) nga qytetarët (për secilin qytetar veç e veç). Pranë Drejtorisë së “Zhitoprometit” në Prishtinë mbahej trajnimi-kursi njëmuor, për nëpunësit e stacioneve grumbulluese në Kosovë. Kursin e vijonin 32 nëpunës. Pas përfundimit të kursit nëpunësit do të angazhoheshin që të kryenin punët teknike pranë stacioneve (pikave) rekuizuese të “Zhitoprometit”, shumicën si depozitë.³⁰ Rëndësi të madhe për rekuizim kanë luajtur edhe stacionet, të cilat bënë mbledhjen e produkteve të ndryshme siç ishte “Zhitoprometi”, ku në një akt është thënë se me rastin e zbatimit të rekuizimit të dhunshëm, bashkë me organet e pushtetit popullor të jenë edhe organet e “Zhitoprometit” dhe të koordinoheshin me njerëzit tonë për ditën e zbatimit të rekuizimit të dhunshëm.³¹

Roli dhe mbikëqyrja e Prokurorisë Publike për zbatimin e rekuizimit

Shteti i RPFJ-së, gjatë viteve 1945-1952, nxori ca ligje për rregullimin e çështjeve ekonomike, financiare e politike, por ligj specifik për zbatimin e grumbullimit-marrjes së prodhimeve bujqësore e blegtorale-“Tepricave” nuk kishte aprovuar e as lëshuar as për Kosovë. Hulumtimet që i kemi bërë nëpër arkiva të ndryshëm, dokumenteve ende të papublikuara, dokumente dhe materiale të publikuara edhe shumë autorëve në shkrimet e tyre, nuk kemi hasur në asnjë dokument që pasqyron ndonjë ligj të veçantë që i dedikohet

²⁹ AQP, KPRR-Podujevë, K-3, Dok. bes. nr. 1389, 13.09.1950, KE i KPP Komisariati për Furnizime Shtetërore, dërguar kryetarit të KPP-së, (Lënda: Udhëzim për zbërthimin e planeve të rekuizimit të detyruar në prodhues).

³⁰ *Jedinstvo*, 1946.

³¹ Po aty, “Zhitopromet,” Prishtinë, 24 dhjetor 1946, Prokuroria Publike për Kosovë, (Lënda: Pasqyra e pjesës së kryer dhe të pakryer të rekuizimit të drithërave të bardha (shpatijeve).

zbatimit të rekuizimit-gjegjesisht politikës rekuizuese. Bashkëkohësi Zef Deda rrëfen se në vitet 1945-1948, grumbullimi i tepricave ishte bërë vetëm me urdhër të qeverisë dhe se nuk kishte ndonjë ligj specifik. Tek në vitin 1947/48, Republika e Shqipërisë filloi me publikimin e ca urdhërësive, udhëzimeve e dekreteve ligjore, që ta zbatonte politikën rekuizuese.³²

Që rekuizimi të kishte sukses sa më të mirë, udhëheqësit krahinorë të organizatave masovike kishin organizuar në nëntor, një javë sulmuese për rekuizim të realizuar (zbatuar). Organet e pushtetit popullor, i thërrisnin të gjithë ata prodhues që nuk i kishin dorëzuar tepricat, të shkonin e t'i dorëzonin, përndryshe do t'iu duhej të shkonin në prokurori publike për t'u përgjigjur para gjykatësit popullor. Prokuroria publike bashkë me organet e pushtetit popullor do të ndërmerreshin masat më urgjente efikase dhe me të drejta për t'u (kryer) arritur caku i dëshiruar.³³

Ministria e Tregtisë dhe Furnizimit e RP të Serbisë kishte mbajtur konferencë me të gjitha komisionet e qarqeve për tregti dhe furnizim. Ministria, të pranishmëve u kishte dhënë udhëzimin sipas të cilit rekuizimi nuk duhej kuptuar si masë e përkohshme, por sistem i vendosur shtetëror, si një mënyrë e këmbimit të të mirave në mes fshatit dhe qytetit dhe ishte vendosur që të ndërmerreshin këto masa urgjente: a). Gjatë muajit nëntor duhej dorëzuar të gjitha tepricat detyrimore të drithërave të bardha dhe misrit. b) Rekuizimi i perimeve (patateve, fasules, lakrave, qepëve etj.) duhej organizuar sipas sistemit të rekuizimit të tepricave të lira të drithërave, në mënyrë që mos të lejoheshin prodhuesit që t'i grumbullonin perimet gjegjësisht t'i mbanin në shtëpi, por sipas ligjit kërkohej që ato të lëshoheshin-qiteshin në qarkullim (shitje). c) Qarkullimi në mes fshatit dhe qytetit duhej kanalizuar përmes organeve shtetërore dhe kooperativave e jo përmes spekulesve të sektorit privat. ç) Të punohej plani i saktë i furnizimit me bukë, sepse ishte e pamundur që të kishte porcione (shujta) për të gjithë, kështu që duhej të bëhej revidimi i porcioneve (shujtave-kartelave në atë mënyrë që shujtat nuk do t'u jepeshin atyre të cilët kishin drithë të vetin: punëtorët,

³² Rrëfim nga Zef Deda, i lindur më 20.01.1926, Intervista e realizuar më dt. 19.07.2022, Velipojë-Shqipëri, profesioni bujk. Funksionet: kryetar lokaliteti në Velipojë, pastaj sekretar dhe drejtor kooperative në Velipojë.

³³ ASHK, PP e KAKM, 1947, K.4, dok. bes. nr.8/47, 6.I.1947-Prisithnë, (Raport mbi rekuizimin e drithërave të shpatieve? dhe misrit në vitin 1946/47).

fshatarët, invalidët). d) Duhej të ndalohej shitja e lirë e artikujve racionalë, sidomos në Kosovë ku të gjithë artikujt ishin në shitje të lirë. Kjo e çrregullonte apo e pamundësonte tërë sistemin tonë furnizues. Diskutimet dhe konkluzat nga ajo konferencë ishin shpallur në shtypin ditor, ndërsa me shkrim ishin dërguar edhe në komisione.³⁴

Në bazë të qarkores së Prokurorisë Publike e Republikës Popullore të Serbisë (PPRPS), Nr. 835/46 të dt. 22.XI.1946 ua kemi dërguar të gjitha Këshillave Popullorë Vendorë (KPV) të Qarkut dhe stacioneve grumbulluese, me qëllim të rekuizimit të dhunshëm të tepricave, andaj në këtë aspekt është arritur rezultat i mirë. Kështu veç është rekuizuar 96% e drithërave të bardha, me të cilat ky rreth disponon, përqindja tjetër do të rekuizohej në afat të paraparë”.³⁵

Se RPFJ-së ishte bërë kopje e BRSS-së tregon dokumenti i mëposhtëm në aplikimin e legjislaturës dhe rekuizimit të tepricave. PPRPS më 30.IV.1947 ua kishte dërguar materialin PP, ndërsa tani Prokuroria Publike (PP e KAKM), në Prishtinë më 15.V.1947 e informonte PPRPS-në në Beograd se në lidhje me aktin e saj rrept. bes. nr.7/47 të dt. 30.IV.1947 kishte pranuar 14 kopje “Udhëzime të Prokurorisë gjenerale të BRSS-së” dhe 64 kopje të ligjërimit të “Legjislacionit” nga dr. Leko Gershkoviqi si dhe ligjërime të tjera, se kopjet e ligjërimit ua kishin dërguar të gjitha qarqeve të PP-së, ndërsa nga një ekzemplar e kishin ndaluar për PP-në të KAKM-së, se tre ekzemplarët e mbetur ishin mbajtur te prokurori publik i KAKM-së.³⁶

Duhet vërejtur (dalluar) dhe njohur me rëndësinë e rregullores së re për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë sonë në përgjithësi e posaçërisht për realizimin praktik të qarkullimit në mes të prodhuesve fshatarë (bujqësorë) dhe industrialë, në mënyrë që prokurorët publikë sa më drejt të kryejnë funksionin e vet mbikëqyrës mbi plotësimin e dispozitave të urdhëresës në fjalë (të theksuar). Nga shkaqet e tilla iu preferohej organeve të prokurorive

³⁴ ASHK, PP e KAKM, K.4, dok. bes. nr.835/46, PPRPS-Beograd, 22 N.1946, dërguar Prokurorive Publike të KA të Vojvodinës, të KA të Kosovës, të gjitha prokurorive të qarqeve, të rretheve. (Lënda: Masat e pushtetit popullor për grumbullim urgjent të tepricave të drithërave, të perimeve sektorit për organizim më të mirë të shpërndarjes së tyre.

³⁵ ASHK, PP e KAKM, K-4. Ndihmësprokurori publik për KM, bes. nr.92, 23.XI.1946, përgjigje në qarkoren e PP të KAKM dhe PPRPS.

³⁶ ASHK, PP e KAKM, K -4, PP e KAKM, nr.5/47, Prishtinë 15.05.1947.

publike sidomos atyre që udhëheqin me sektorin e mbikëqyrjes së përgjithshme, që të analizojnë kuptimin e urdhëresës dhe të gjitha dispozitatë të cilat kohë pas kohe do të bëheshin-silleshin nga organet kompetente të Drejtorisë Shtetërore lidhur me zbatimin e saj në mënyrë që me intervenimet e veta me kohë të mënjanohej çdo lojë me dispozitat e urdhëresës apo devijimi i frymës së saj. Në këtë drejtim duhej posaçërisht kushtuar kujdes gjetjes dhe zbulimit të të gjitha mënyrave me të cilat po luhej me dispozitat e urdhëresës e sidomos në aspektin e fshehjes së tepricave, ikjes së kontrollit shtetëror dhe evidentimin e të njëjtave.³⁷

Për ta ditur për gjithë rajonin se sa ishte miratuar teprica, sa ishte blerë deri atëherë, si dhe sa ishte blerë gjatë javës për të cilën raportohej, në vazhdimësi duhej të raportohej për javët e kaluara duke i shënuar datën, dhe përmes atyre shënimeve, tepricat të shfaqeshin në kilogram dhe në përqindje. Theksohet se kjo ishte detyrë kryesore dhe se me të duhej të angazhohej vetë prokurori publik.³⁸

Me qëllim të kryerjes së kësaj detyre duhej që prokurorët publikë të njoftoheshin me udhëzimet e Drejtorisë së Përgjithshme, Drejtorisë Kryesore për rekuizim të MTF të RPS të cilat ishin me nr. 11421/48 të dërguara të gjitha drejtorive për rekuizim, ndërsa prokurorët publik t'i dërgonin deri më 26.VI.1948 raporte konkrete të shkurtra për të gjitha parregullsitë, gabimet dhe mosangazhimet e hetuara në terren dhe intervenimet e tyre.³⁹ Një udhëzim tjetër vinte prapë nga PPRPS-ja më dt. 23.VI.1948, që udhëzonte PP-në e KAKM-së, Krahinës Autonome të Vojvodinës (KAV) dhe qarqet që në bazë të përshkrimit të rregulloreve mbi rekuizimin e drithërave dhe udhëzimeve për zbatimin e tyre KP-të përmes komisioneve të bënin vlerësimin e prodhimeve dhe vlerësimin e obligimeve të detyrueshme të familjeve të caktuara dhe këtë:

³⁷ ASHK, Fondi-Prokuroria Publike e KAKM, kutia. 4, Dok. nr. 2403/46, Prokuroria Publike e RP-së së Serbisë, 14 maj 1946, Beograd, (Lënda: njohja me dispozitat-rregullat e rregullores mbi grumbullimin e drithërave në vitin ekonomik 1946/47), dërguar të gjithë prokurorive publike.

³⁸ ASHK, Fondi-Prokuroria Publike e KAKM, PPRPS, bes. nr.835/46, 9 shkurt 1947, shkresë dërguar të gjitha prokurorive si: KA. Vojvodinës, KA. Kosmet, të gjithë prokurorëve të RP. të Serbisë.

³⁹ ASHK, Prokuroria Publike (PP e KAKM), K-4, PPRPS, Rrept. Bes. nr.14/48, 19.06.1948, Beograd, Kontraktimi i drithërave.

1. Që secili prokuror publik në rrethin e vet të zgjedhë 2-3 fshatra ku puna e KP-së dhe komisioneve ishte e dyshimtë, që në ara të vërtetojë punën e komisioneve në vlerësimin e prodhimit.

2. Kujdes të veçantë t'iu jepej sipërfaqeve për lëvrim dhe sipërfaqeve të mbjella me drithëra të bardha të familjes të caktuar, sepse siç thuhet në dokument, elementet spekulative përpiqeshin të fshehin sipërfaqet e tyre për lëvrim e sidomos ato me drithërat e bardha.

3. Në secilën nga ato fshatra të hulumtojë 5-6 familje të pasura dhe të mesme që të vërtetojë punën e komisioneve nëse e kishin caktuar drejt tepricën e tregut, kategorizimin e familjeve dhe lartësinë e dërgesave obligative.

Me qëllim të kryerjes sa ma të mirë të detyrave, prokurorët publikë duhej të vënin lidhje me sekretarët e KPV-ve dhe në marrëveshje me ta të përcaktonin një anëtar të Këshillit Ekzekutiv (KE), ndonjë ekspert të besueshëm, i cili prokurorëve publikë do t'ju ndihmonte në terren me rastin e kontrollimit të punës së komisioneve. Po kështu, kërkohej nga prokurorët publikë t'i njoftonin KP-të me udhëzimet për realizimin e dispozitës, t'i qaseshin urgjent realizimit të detyrës, ashtu që komisionet të ngrinin vetëdijen e përgjegjësisë dhe të kontribuonin në angazhimin e tyre më të madh në luftimin e oportunitetit dhe byrokratizmit në punën e komisioneve dhe KP-s, dhe të gjithë prokurorët publikë të rretheve t'i dërgonin raportet për konstatimet në terren drejtpërdrejt kësaj PP deri më 2 korrik 1948.⁴⁰ Krahës rekuizimit të drithërave të bardha, pasonte edhe rekuizimi i kafshëve. Lidhur me këtë PPRPS-ja më 03.IX.1948 u dërgonte të gjithë prokurorëve publike të qarqeve (PPQ), udhëzimin mbi zbërthimin e disa detyrave në kuadër të planit rekuizues:

1) Prokurorët publikë në lidhje me detyrat e parashtruara dhe zbatimit të dispozitave të Rregullores për rekuizimin e kafshëve për therje të kujdeseshin:

a) Si a ishte bërë zbërthimi i planit të rekuizimit nga ana e KPRR-së dhe KPV-së dhe realizimit të tij?

⁴⁰ ASHK, PP e KAKM, K-4, PPRPS, Rrept. Bes., nr. 14/48-2, 23.VI.1948 Beograd, Kontrolli i vlerësimit të prodhimit dhe obligimet me drithëra të bardha.

b) Si ishin përcaktuar dërgesat e obligueshme nga ana e KPV-së në familje të caktuara (neni 8 pika a-d të rregullores)? A kishte qenë kriteriumi në bazë të udhëzimeve të pranuar mbi përcaktimin e fuqisë ekonomike të familjes, duke pasur kujdes që barra e rekuizimit të kafshëve të binte mbi familjet pasanike?

c) A e kishin kryer KP-ja rekuizimin e obliguar të kafshëve në bazë të udhëzimeve për rekuizim të jashtëzakonshëm me të cilin ishin informuar PP-ja nën shifrën rrept. bes.nr.21/48?

ç) Duhej pasur kujdes veçanërisht në sigurimin e ushqimit, vendosjes dhe mbrojtjes veterinarë të kafshëve në sektorin e kooperativave dhe atë shtetëror.

Prokurorët gjatë zbatimit të këtyre detyrave duhej që krahas Rregullores të njoftoheshin me të gjitha udhëzimet, të cilat i kishin marrë KP-të dhe drejtoritë për rekuizim.

2) Në aspektin e zbatimit të detyrave të kontrollit në bazë të rregulloreve ekzistuese mbi furnizimin të shfrytëzohej edhe rregullorja rrep.bes.nr.21/48 të dt. 17.VII.1948 mbi çmimet e prodhimeve bujqësore në tregun e lirë (Gazeta zyrtare nr. 57/48 e RPS) me të gjitha dispozitat tjera. 3) Në lidhje me kontrollin sipas rregulloreve, të shikohej se si realizohej rekuizimi i prodhimeve bujqësore nga ana e amvisërive (familjeve) të imëta, pastaj evidenca e triskave dhe zbatimi i planit të furnizimit me mallra industriale etj.⁴¹

Që të realizohej jo vetëm rekuizimi i tepricave, por edhe zhvillimi i segmenteve të tjera mbështetur në ligje e rregullore, po japim në vazhdim institucionin e aparatit prokurorial në nivele PP të KAKM-së. Më tutje po japim listën tabelore të datës 01.IX.1948 të zbërthyer në formë tjetër. Në listën tabelore gjenden rubrikat: nr. rend., emri dhe mbiemri, viti dhe vendi i lindjes, kualifikimi shkollor, thirrja, në cilën detyrë gjendej, numri zyrtar i dosjes dhe vërejtje.

1. Shukri A. Ali, i lindur në vitin 1919 në Mitrovicë, student i drejtësisë në vitin II, punonte në detyrën e prokurorit publik të KAKM-së dhe kishte numrin e dosjes 183.073.

⁴¹ ASHK, PP e KAKM, K.9, PPRPS, rrept.bes.nr.18/48, 3. IX.1948, Beograd.

2. Vukçeviq P. Radoje, 1909, Jarmasi, rrethi i Podgoricës (Mali i Zi), jurist i diplomuar, referent i lartë i jurisprudencës, ndihmës i prokurorit publik të KAKM-së, 183.074.
3. Popoviq I. Goroljub, 1910, Gjilan, jurist i diplomuar, referent juridik, ndihmës i prokurorit publik të KAKM, 183.105.
4. Çukaloviq S. Todor, 1916, Sreckë, rrethi i Maleve të Sharrit, jurist i diplomuar, referent juridik, ndihmës i prokurorit të KAKM-së, 183.102.
5. Aciq A. Vidosava, 1921, Prishtinë, matura e gjimnazit, nëpunës praktikant, udhëheqës i administratës në PP të KAKM-së, 183.075.
5. Tomiq M. Toma, 1912, Prishtinë, absolvent i drejtësisë me provime të dhëna të vitit të dytë, referent i ri i drejtësisë i klasës III, kryen detyrën e gjykatësit hetues, 183.080.
6. Kovaçeviq L. Dobrivoje, 1924, Deviq, rrethi i Drenicës, gjashtë klasë të gjimnazit, referent i ri personal, punon sipas linjës personale, 283.280.
7. Zhoriq F. Andrija, 1908, Mushnikovë, Rrethi i Maleve të Sharrit, një klasë të gjimnazit dhe shkollën e nënoficerëve, administrator i vjetër, manipulant i klasës III, nëpunës për llogaritje, 183.076.
8. Semani N. Hamza, 1924, Prizren, matura e gjimnazit, student i drejtësisë, viti i parë, manipulant administrativ i kl. III, punon në administratë, 183.077.
9. Borani Jasheviq Z. Darinka, 1913, Prishtinë, katër klasë të gjimnazit, ndihmësadministrator, manipulant i kl.III, punon në administratë, 183.064.
10. Grushti K. Nedima, 1928, Mitrovica e Kos. Dy klasë të gjimnazit, shkruar i klasit I, llojit I, punon në administratë, 183.382.
11. Sadiki I. Hamdi, 1920, Prishtinë, tri klasë të shkollës fillore, ndihmësnëpunës i klasës II, shërbyes, 183.475.
12. Sulejmani R. Nazmi, 1910, Prishtinë, shkolla fillore, ndihmësnëpunës i klasës I, shërbyes, 183.476⁴².

⁴²ASHK, PP e KAKM, K.7, Lista e personelit të PP të KAKM-së dhe prokurorisë së rrethit të Graçanicës dhe qytetit të Prishtinës më 01.IV.1948. Sqarim: Vazhdojnë listat për rrethet e tjera të KAKM-së. Shërbimi i Prokurorisë Publike i KAKM-së dhe rretheve ka gjithsej 41 punëtorë.

Sa i përket ndjekjes penale dhe administrative në vazhdim duhej përmbajtur kësaj rregulloreje të Gjykatës së Republikës Popullore të Jugosllavisë të dhënë me njoftimin rrept.bes. nr.21/48 nga 15.VII.1948, andaj ky njoftim duhej përcjellur në të gjitha PPQ-ve dhe PPRR-ve⁴³. Masat që i ndoqën strukturat ekzekutive për rekuizimin e tepricave, ishin shumë të pamëshirshme për popullin e Kosovës në përgjithësi, por në veçanti për atë shqiptare, të cilët dhunshëm iu nënshtuan pushtetit jugosllav pas LDB-së dhe po ashtu dhunshëm me format më të rrepta për realizimin e planit për rindërtimin dhe forcimin e shtetit jugosllav. Detyrë kryesore e prokurorive publike ishte që në atë periudhë të intervenonte me qëllim të ndjekjes kudo që paraqitej nevoja për të siguruar realizimin e plotë të planit të rekuizimit të drithërave të bardha. Për këtë qëllim prokurori publik do të intervenonte edhe në dhënien e vendimeve dhe në shqyrtimin e ankesave sa më shpejt dhe krahas kësaj juridikisht të aplikoheshin ligjet dhe udhëzimet ekzistuese.

Te prodhuesit duhej të vendosej disiplinë e plotë dhe të sigurohej autoriteti i KP-së, vendimeve të tyre dhe masave të cilat do të ndërmernte në lidhje me rekuizimin dhe realizimin e planit. Për këtë prokurorët publikë që në fillim duhej të ashpësonin kursin ndaj të gjithë prodhuesve, të cilët nuk i plotësonin obligimet e tyre ose përgjigjeshin pa rregull. Pa marrë parasysh çmimin duhej menjëherë që kundërshtia të shkatërrohej kudo që lajmërohej.

Kundër prodhuesve, sipas drejtësisë, do të ndërmerreshin masa administrative me ndjekje dënimi ndaj të pjesërishmëve që të plotësonin obligimet ose përgjigjen e parregullt në thirrjet e KPV-ve. Në raste të tilla duhej kërkuar që parësisht të shqiptoheshin dënime me punë përmirësuese (neni 21 i Rregullores), që procedura të ishte e shpejtë dhe efikase, kurse dënimet e shqiptuara të kryheshin sa më shpejt. Raportet nga terreni tregonin për kundërshtimin e elementit kulakë rreth shmangies ndaj obligimeve të rekuizimit. Nëse në disa vende ose rrethe lajmërohej kundërshtim përmes sabotimit dhe qëndrimit prej kulaku të pronarit, atëherë me udhëheqësit politikë të rrethit dhe organet e Ministrisë së Punëve të Brendshme të analizonin situatën dhe të konstatonin cilët ishin ata prodhues konkretë për të cilët kishte ardhur deri te pengimi i rekuizimit ose të cilët me kryeneçësi u

⁴³ ASHK, PP e KAKM, K-9. PPRPS, rrept.bes.nr.14/48, 25. XII.1948, Beograd, Luftimi i spekulimit me drithëra dhe të produkte të përpunuara.

ikin kryerjeve të obligimeve të tyre. Kundër prodhuesve të këtillë të ndërmerreshin ndjekje penale, që përveç dënimit në kohë t'ju shqiptohej edhe konfiskimi i tërësishëm i pronës. Për këto raste të kërkohej pëlqimi më parë të prokurorit krahinor përkatësisht të qarkut. Po kështu kërkohej që në buletinet javore të Krahinës, prokurorët e qarkut të përshkruanin rastet për të cilat ishin shqiptuar dënimet, konfiskimet me të dhëna të përafërta mbi veprën dhe kryesinë, ndërsa për dënimet administrative të jepnin përmbledhtazi fotografinë e personit me analizën se për çfarë arsye kishte qenë e nevojshme marrja e një mase të tillë dhe ajo masë si kishte ndikuar në rekuizimin e mëtejshëm.⁴⁴

Emri dhe Mbiemri	Nga është, rrethi	Shenja e Dok.	Gjendja e pasurisë	Nr. i anët.	Mendimi ynë
Sylë Rama	Letanc Llap	Bes.139/49 18.X.1949	16,98 ha tokë e pun.	18	Konfiskim i plotë i lireshin 7 ha arë
Vladan Pribaković	Dumnicë e P. Llap	-----	21 ha tokë e pun.	12	Konfiskim i plotë i lireshin 4-5 ha
Radovan Joçiq	Livadicë Llap	Bes.114/49 28.IX.1949	10.12 ha tokë e pun.	6	Konfiskim i pjesshëm i lireshin 6 ha arë
Svetomir Javonović	Bajçincë Llap	Nr.114/49 01.X.1949	16,40 ha tokë e pun.	9	Konfiskim i pjesshëm i lireshin 10 ha arë
Hasan Fejza	Busi Graçanicë	-----	7,11 ha tokë e punueshme	21	Nuk kërkohej konfiskim
Sali Uka	Dumnicë e P. Llap	Bes. 139/49-3 20.X.1949	14,44 ha tokë e pun.	9	Konfiskim i plotë

⁴⁴ ASHK, PP e KAKM, K.9, PPRPS, rrept.bes.nr.45/1949, 20.VIII.1949, Beograd.

					i liheshin 5 ha.
Latif Ahmeti	Koqli Llap	Bes. 139/49-4 25.X.1949	9,74 ha tokë e pun. 8 ha livadhe. 20 ha mal	20	Të mbahej në paraburgim deri në fund të rekuizimit
Hamit Sejdia	Rep Llap	bes.139/49-2	10 ha. tokë e punueshme	22	Dënim në para
Murat Hasani	Llaushë Llap	bes.139/49-3	11,43 ha tokë e pun.	12	Konfiskim i pjesshëm i liheshin 5 ha
Ibrahm Mustafa	Prishtinë Graçanicë	Bes.139/49 28.X.1949	6 ha tokë e pun.	5	Konfiskim i pjesshëm i liheshin 2 ha
Salih Tahiri	Prishtinë Graçanicë	Bes.139/49 28.X.1949	5 ha tokë e pun.	6	Dënim në para
Osman Shabani	Bellopojë Halabak	bes.139/49 30.X.1949	9.30 ha tokë e p.	6	Mbajtje në burg deri në mbarim të rekuizimit ⁴⁵

Pasqyrë e personave të dënuar me konfiskim të pasurisë.

⁴⁵ASHK, Penale e KAKM, K.2, Lista e personave të gjykuar dhe dënuar lidhur me rekuizimin e drithërave të bardha, Listën e bëri: Ollga Popoviq - Vërejtje: Lista e personave të dënuar me konfiskim të pasurisë”, kjo listë statistikore nuk ishte nënshkruar as nuk ishte vërtetuar nga askush, është e shkurtuar, pra përfshinë vetëm rrethin e Llapit dhe Graçanicës.

Administrative				Për mosdorëzim të grurit				
Emri dhe Mbiemri	Fshati KPV	Sipërf. e punuar	Të ngark. me drith, të bardha	Sa ka dorëzuar	Sa s' ka dorëzuar	Dt. e nisjes së proc.	Dënimi nga gjyqi apo KPQ	Data e dënimit
Miluko Petkoviq	Halabak Bellopojë	4,60ha	1 683 kg	400 kg	1283kg	27.IX. 1949	20.000 din.	13.X.' 49
Halit Zeqiri	Miravac Shtedim	4 ha	1032 kg	404 kg	628 kg	29.IX.' 49	5.000 din.	13.X.' '49
Milivoje Maksoviq	Sibovc i P. Lluzhan	6.46 ha	1940 kg	1 425 kg	515 kg	08.X.'4 9	20.000 din.	13.X.' 49
Muslija Rrahman	Sibofc i P. Gllamnik	-	-	-	-	-	50.000 din.	06.X.' 49
Sherif Latifi	Podujevë	-	-	-	-	-	50.000 din.	06.X.' 49
Jakup Fazliu	Ballofc Shtedim	-	-	-	-	-	50.000 din.	06.X. 49
Mursel Rashiti	Llapashticë e Poshtme	-	-	-	-	-	50.000 din.	06.X.' 49
Jetullah Jashari	Batllavë	3.80 ha	1 300 kg	-	1 300 kg	22.IX.'4 9	10.000 din.	22.IX.' '49
Bajram Kajtazi	Peran	5.50 ha	1 404 kg.	-	1 404 kg	23.IX.'4 9	3 muaj punë përmirë sueshme	06.X.' 49
Xhemail Sekiraqa	Tërnavë	5.89 ha	1 189 kg	-	1 189 kg	25.X.'4 9	-//-	06.X.' 49
Zhivatko viq Stoja	Batllavë	3 ha	670 kg	338 kg	332 kg	25.X.'4 9	-//-	06.X.' 49
Boshko Angjeliq	Bradash	-	-	-	-	25.X.'4 9	-//-	06.X.' 49

Lubomir Radojkov iq	Ballofc Shtedim	-	1988 kg	996 kg	992 kg	27.X.'4 9	-//-	06.X.' 49
Shaban Ajđini	Ballofc	2.60 ha	787 kg	294 kg	943 kg	27.X.'4 9	-//-	06.X.' 49
Svetolik Steviq	Lividica Shtedim	8 ha	1 108 kg	528 kg	680 kg	27.X.'4 9	-//-	06.X.' 49

Lista e personave të dënuar për mosdorëzim të grurit në periudhën ekonomike 1949.⁴⁶

Fushata për mbledhjen e prodhimeve bujqësore e blegtorale u zbatua edhe në viset e tjera të ish-Jugosllavisë, zbatimi i saj i kësaj fushate në Kosovë, veç karakterit ekonomik pati edhe karakter politik, andaj edhe pasojat e saj janë të natyrës ekonomike, politike dhe nacionale, se numri më i madh i popullsisë ishte shqiptare.⁴⁷

⁴⁶ ASHK, Prokuroria Penale e KAKM, K.2, Prokuroria Publike e Rrethit (PPRR e Podujevës), Lista e personave për mosdorëzim të grurit në periudhën ekonomike 1949.

⁴⁷ Mehmet Gjoshaj, "Mbledhja e tepricave në Kosovë si formë e plaçkitjes ekonomike", botuar në vitin 2009, 368.

Blerim CARANI

SUMMARY

THE INFLUENCE OF STATE-"PEOPLE'S" INSTITUTIONS ON THE IMPLEMENTATION OF REQUISITION IN KOSOVO UNDER THE SUPERVISION OF THE PUBLIC PROSECUTION DURING THE YEARS 1945-1952

Different institutions have given various notes regarding the general areas worked, for the fully cultivated surfaces, for the general entrances from the harvests, etc., while the turmoil was also created by the notes from the field activists who continuously discovered hidden "surfaces," evaluating the entrances during "green" or rainy periods. The lack of accurate notes complicated the work of requisition plans, while their implementation rates varied in relation to statistical notes. In reality, statistics and evidence have been cancerous wounds for the comprehensive agricultural and requisition policy during the entire period of requisition. The verified plans of requisition and the balances for food were found in front of the government institutions of the Republic and lower institutions as a planned duty (duty from the plan) which must be implemented as soon as possible.

The state's goal was through requisition to create funds, to stabilize the economic state of the country, but instead did not stabilize the economy, but rather damaged it because people no longer worked the land, lost their will to work when they knew they had to give their products to the state. This plundering campaign for the requisition of "surpluses" aimed to pressure Albanians to submit to power. However, the pressure, imprisonments, and political convictions, in fact, were organized pressure from the state, for the first time facing reality, which means they did not help fulfill unrealistic plans that often changed. The villager tried to resist the extensive pressure from state measures through passive resistance and finding all possible ways to avoid them, in order to fulfill their own duties.